
OPERATORI I BLERJEVE TË PËRQENDRUARA SH.A

Data: 24.07.2026

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Mallra

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

**OBJEKTI: “BLERJE STANDARTE DROGE DHE STANDARTE EKSPLOZIVI”, E
NDARË NË LOTE**

LOTI 1 “BLERJE STANDARTE DROGE”

LOTI 2 “BLERJE STANDARTE EKSPLOZIVI”

KONTRATË

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (FPP): *Reagentë kimikë 33696300-8*

VLERA E FONDIT LIMIT: “Blerje standarte droge dhe standarte eksplozivi”, me fond limit të kontratës **1,624,967.6** (një milionë e gjashtëqind e njëzet e katër mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e shtatë pikë gjashtë) lekë pa TVSh, e ndarë në lote:

Loti 1 “Blerje standarte droge”, me fond limit të kontratës 1,183,077.3 (një milion e njëqind e tetëdhjetë e tre mijë e shtatëdhjetë e shtatë pikë tre) lekë pa TVSH.

Loti 2 “Blerje standarte eksplozivi”, me fond limit të kontratës 441,890.3 (katërqind e dyzet e një mijë e tetëqind e nëntëdhjetë pikë tre) lekë pa TVSH

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit Nr.162/2020 “Për prokurimin publik” (të ndryshuar) nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), Autoriteti Kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara në rolin e Organit Qëndror Blerës, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT: TË NJËJTA PËR TË GJITHA LOTET

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;

Argumentimi: Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertes”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, si dhe në mbështetje të nenit 26, nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Neni 82, i LPP përcakton se “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”. Neni 83 i LPP përcakton se “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kriteret duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 76 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 25 të VKM-se nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2023, 2024, 2025), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 39 % e vlerës së fondit limit për secilin prej loteve / shumatores së loteve për të cilat konkurron. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është në nenin 77, pika 1 dhe 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar; nenin 43 pika 2/c të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “*Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata*”. Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të operatorëve ekonomik ofertues,

duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitet ekonomike dhe financiare për të përmbushur kontratën sic është parashikuar nga Autoriteti Kontraktor.

Në pikën 1 të nenit 77 të LPP përcaktohet se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.” dhe në pikën 3 të tij përcaktohet se: “3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohej nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës. Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohej operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë. Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.”

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: jo më e vogël se 39 % e vlerës së fondit limit për secilin prej loteve / shumatores së loteve për të cilat konkurron, është në përputhje me përcaktimet në nenin 43 pika 2/c të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, ku përcaktohet se: “Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohej operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: c) 40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në kontratat e shërbimit me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme”.

Në rastin konkret Njësia e Prokurimit ka konsideruar të arsyeshme që vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 39 % e vlerës së fondit limit për secilin prej loteve / shumatores së loteve për të cilat konkurron, me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik, nxitjen e konkurrencës ndërmjet operatorëve ekonomikë si edhe sigurimin e një trajtimi të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë ofertuesit e mundshëm ekonomikë. Kjo vlerë është kërkuar duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, vlerën e fondit limit, me qëllim që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorit ekonomik, të cilët duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.3 Kapaciteti teknik:

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën jo më pak se 19 % e vlerës së fondit limit për secilin prej loteve / shumatores së loteve për të cilat

konkurron. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- a) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 “Kërkesat për kualifikim”, pikat 1 dhe 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, neni 42 pika 3, neni 55, pika 4(b) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar.

Në pikën 1 të nenit 77 të LPP përcaktohet se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.” dhe në pikën 4 të tij përcaktohet se: “4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”. Gjithashtu në nenin 42 pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 të ndryshuar, përcaktohet se: “3. Kur kontratat për punë/mall/shërbim ndahet në lote, autoriteti/enti kontraktor duhet të hartojë kërkesat e veçanta të kualifikimit për secilin lot. Kërkesat duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin, natyrën dhe vlerën e lotit.”

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 19 % e vlerës së fondit limit për secilin prej loteve / shumatores së loteve për të cilat konkurron. Kjo vlerë është vendosur duke marrë parasysh se vlera e fondit limit për të gjitha lotet është nën kufirin e ulët monetar dhe përcaktimeve të bëra në nenin 55 pika 4 gërma (b) e VKM nr 285 dt 19.05.2021 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku përcakton se: “Lidhur me kërkesat për përvojën e ngjashme, vlera e kërkuar në procedurat e thjeshtuara duhet të jetë: b) Për kontratat e mallrave dhe shërbimeve vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 20% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.”

Përqindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe pervojën e operatorëve ekonomik ofertues, në ofrimin e mallrave të ngjashëm me objektin e prokurimit për realizimin me sukses të kontratës.

2.Operatori ekonomik duhet të paraqesë skedë teknike/katalog teknik nga prodhuesi për të gjitha mallrat objekt prokurimi, ku të pasqyrohen specifikimet teknike të kërkuara, në mënyrë që të krahasohet pajtueshmëria e tyre me specifikimet teknike të kërkuara në dokumentet standarde të tenderit, të përcaktuara në shtojcën 6 “Formulari i specifikimeve teknike”.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është bazuar në nenin 77 pika 1 dhe 4 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar parashikohet se: *“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe pervojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm pervoje që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, pervojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”* dhe në nenin 40 pika 6/b të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. ku përcaktohet se: *“6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: b) fotografitë apo katalogët teknikë;”*. Me anë të këtij kriteri, kërkohet që të verifikohet përputhshmëria e specifikimeve teknike, duke garantuar që produktet e ofruara i përmbushin të gjitha kërkesat teknike, funksionale dhe standartet e përcaktuara në specifikimet teknike në dokumentat e tenderit.

Vendosja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi, i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të ofruar mallrat e kërkuar, si dhe për të krahasuar pajtueshmërinë e specifikimeve teknike dhe standartet e kërkuara nga Autoriteti Kontraktor në dokumentet e tenderit, me specifikimet teknike të mallrave të ofruara nga operatori ekonomik. Nisur nga lloji i mallit që kërkohet, të cilat janë të rëndësishme për punën e Laboratorit në Institutin e Policisë Shkencore, është e nevojshme që autoriteti kontraktor të sigurohet për mallrat që i ofrohen nga operatorët ekonomik pjesmarrës të vërtetuar nëpërmjet dokumenteve si katalogë/ skedë teknike nga prodhuesi i mallit. Gjithashtu katalogët/skedat teknike do të shërbejnë edhe për marrjen në dorëzim të mallit nga Autoriteti Kontraktor përfitues.

3.Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë, ku të deklarojë se afati i skadencës së mallrave objekt prokurimi, do të jetë sipas kushteve të përcaktuara në specifikimet teknike, në shtojcën 6 “Formulari i specifikimeve teknike”.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar ku përcaktohet se: “4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.” dhe pika 8 e nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, ku përcaktohet se: “8. Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.”. Nisur nga malli objekt prokurimi, furnizimi i standarteve për Institutin e Policisë Shkencore dhe referuar shtojcës 6 “Formulari i specifikimeve teknike”, në specifikimet teknike janë parashikuar afatet e skadencës së mallrave nga momentin e dorëzimit të tyre në Autoritetin Kontraktor. Me anë të këtij kriteri kërkohet që t’i ofrohet siguri Autoritetit kontraktor përfitues mbi afatin e skadencës së mallit që kërkohen. Referuar specifikimeve teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit, ky kriter është në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike :

Specifikimet teknike, për mallrin objekt prokurimi, plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar).

Specifikimet teknike sipas DST janë hartuar nga grupi i punës i ngritur nga Titullari i Autoritetit Kontraktor përfitues Instituti i Policisë Shkencore si më poshtë për të gjitha lotet, në përputhje me ligjin nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar si dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

SPECIFIKIMET TEKNIKE

LOTI 1 “BLERJE STANDARTE DROGE”

Nr.	Emertimi
1	2
1	Dronabinol [(-)-trans-Δ9-Tetrahydrocannabinol]] 1.0mg/ml
2	Dronabinol [(-)-trans-Δ9-Tetrahydrocannabinol]] 5.0mg/ml

3	Cannabinol (6,6,9-Trimethyl-3-pentyl-benzo[c]chromen-1-ol) 1.0mg/ml
4	Cannabidiol (CBD) 1.0mg/1ml
5	MDMA (RS)-1-(Benzo[d] [1,3] dioxol-5-yl)-N-methylpropan-2- amine. hydrochloride 1.0mg/1ml
6	LSD (Lysergid acid diethylamide) 1.0 mg/ml
7	Methamphetamine HCl (N-Methyl-1-phenyl-propan-2-amine.hydrochloride)ne metanol 1.0mg/1ml
8	Cocaine Methyl-(1R,2R,3S,5S)-3-benzoyloxy-8-methyl-8- azabicyclo [3.2.1] octane-2-carboxylate) 1.0mg1/ml
9	Cocaine Methyl-(1R,2R,3S,5S)-3-benzoyloxy-8-methyl-8- azabicyclo [3.2.1] octane-2-carboxylate) pluhur.
10	Heroin (Diacetylmorphine) 1.0mg/1ml
11	Heroin (Diacetylmorphine) pluhur
12	Fentanyl (1-Phenethyl-4-N-propionylanilinopiperidine) 1.0mg/ml
13	4-CMC (4-chloromethcathinone) 1.0mg/ml
14	2-CMC HCL ((2-chloromethcathinone) 1.0mg/ml
15	Acetylfentanyl (N-(1-Phenethyl-piperidin-4-yl)-N-phenyl-acetamide) 1mg/ml
16	Alpha PVP (α-Pyrrolidinovalerophenone) 1mg/ml
17	Metadone (RS)-6-(Dimethylamino)-4,4-diphenyl-3-hetpanone) 1mg/ml
18	2C-B (4-Bromo-2,5-dimethoxyphenethylamine) ne mg
19	Ketamine (2-(2-Chlorophenyl)-2-methylamino-cyclohexan-1-one) 1mg/ml
20	GBL (gamma-Butyrolactone) 1mg/ml ose 1mg nëse ofrohet pluhur ne mg
21	GHB (gamma-Hydroxybutyrate) 1mg/ml ose 1mg nëse ofrohet pluhur ne mg
22	6-Monoacetylmorphine (6-MAM) 1mg/ml ose 1mg nëse ofrohet pluhur ne mg
23	JWH 210 (4-ethyl-naphthalen-1-yl) (1-pentylindol-3-yl) methanone) 1mg/ml ose 1mg nëse ofrohet pluhur ne mg
24	Protonitazene (N,N-diethyl-5-nitro-2-[(4-propoxyphenyl) methyl]-1H-benzimidazole-1-ethanamine) pluhur
25	Metonitazene (N,N-diethyl-2-[2-[(4-methoxyphenyl) methyl]-5-nitrobenzimidazol-1-yl]ethanamine) pluhur
26	Isotonitazene ((N,N-diethyl-2-(2-(4-isopropoxybenzyl)-5-nitro-1H-benzimidazol-1-yl) ethan-1-amine) pluhur
27	Cannabigerol (2-[(2E)-3,7-dimethylocta-2,6-dienyl]-5-pentylbenzene-1,3-diol) 1mg/ml
28	Cannabichromene (2-Methyl-2-(4-methylpent-3-enyl)-7-pentyl-5-chromenol) 1mg/ml
29	HHC (hexahydrocannabinol) 1mg/ml
30	THCA (tetrahydrocannabinolic acid) 1mg/ml
31	(2S)-2-[-(5R,6R,7R,14S)-9α-Cyclopropylmethyl-4,5-epoxy-6,14-ethano-3-hydroxy-6-methoxymorphinan-7-yl]-3,3-dimethylbutan-2-ol) (Buprenorphine) 1mg/ml 1mg nëse ofrohet pluhur ne mg.

ARGUMENTIM I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE LOTI 1

Standardet e referencës për analizën e lëndëve narkotike dhe substancave psikotrope janë materiale me kosto të lartë, të cilat duhet të ruhen dhe të përdoren sipas kushteve të përcaktuara, për të garantuar stabilitetin dhe saktësinë e rezultateve analitike.

Për nevojat e laboratorit, zgjedhja e ampulave 1 mL ose paketime me 1mg është më e përshtatshme për arsyet e mëposhtme:

Ruajtja e integritetit të standardit. Pas hapjes së ampulës, standardi fillon të ekspozohet ndaj ajrit, lagështisë dhe ndotjes së mundshme. Përdorimi i ampulave 1 mL mundëson konsumimin e plotë ose pothuajse të plotë të përmbajtjes brenda një periudhe të shkurtër, duke minimizuar degradimin e standardit.

Reduktimi i humbjeve. Në laborator, sasia e standardit të përdorur për përgatitjen e kurbave të kalibrimit, kontrolleve të cilësisë dhe validimeve është zakonisht e vogël. Ampulat 2 mL ose 10 mL shpesh nuk konsumohen plotësisht para skadimit të periudhës së rekomanduar pas hapjes, duke sjellë humbje të materialit.

Sigurimi i cilësisë së rezultateve. Përdorimi i standardeve të sapohapura ul rrezikun endryshimit të përqendrimit për shkak të avullimit të tretësit ose degradimit të komponentit, duke garantuar rezultate më të sakta dhe më të riprodhueshme.

Përputhshmëria me praktikën e laboratorëve forenzikë. Laboratorët që kryejnë analiza sipas kërkesave të standardeve të cilësisë (p.sh. ISO/IEC 17025) preferojnë përdorimin e ampulave me vëllim të vogël për të minimizuar rrezikun e kontaminimit dhe për të ruajtur gjurmueshmërinë e standardeve.

Efikasitet ekonomik afatgjatë. Edhe pse çmimi për mililitër mund të jetë më i ulët në ampulat me vëllim më të madh, humbjet nga moskonsumimi i plotë i standardit dhe nevoja për ta asgjësuar atë pas degradimit e bëjnë përdorimin e ampulave 1 mL më ekonomik në praktikë.

Kontrolli ligjor – Standardet që përmbajnë substanca narkotike, psikotrope ose prekursorë kontrollohen nga ligji njësoj si vetë substancat, pavarësisht se janë në sasi shumë të vogla.

Përmbushja e konventave ndërkombëtare – Vendet zbatojnë kërkesat e konventave të OKB-së të viteve 1961, 1971 dhe 1988 për kontrollin e lëvizjes ndërkombëtare të këtyre substancave si dhe ligjin 7975 date 26.07.1995`Per barnat narkotike dhe lendet psikotrope`.

Parandalimi i devijimit – Lejet u mundësojnë autoriteteve të dinë se kush i importon, në çfarë sasive dhe për çfarë qëllimi.

Gjurmueshmëria – Çdo dërgesë dokumentohet, duke krijuar një zinxhir të plotë gjurmueshmërie nga prodhuesi deri te laboratorit.

Verifikimi i marrësit – Autoritetet sigurohen që marrësi është një laborator i autorizuar dhe se standardet do të përdoren vetëm për analiza shkencore ose forenzike.

Në praktikë, procesi zakonisht funksionon kështu:

Nje kompani merr lejen e importit nga autoriteti kompetent në Shqiperi qe eshte MINistria e Shendetesise.

Furnizuesi përdor atë leje për të marrë lejen e eksportit nga autoriteti i vendit të tij.

Vetëm pasi të jenë lëshuar të dyja lejet, dërgesa mund të eksportohet dhe të importohet ligjërisht.

-Materialet referencë të porositura në përqendrime të certifikuara (mg/ml) janë parashikuar për ndërtimin e kurbave të kalibrimit (përgatitjen e pikave të ndryshme të kalibrimit nëpërmjet hollimeve të kontrolluara), si dhe për kryerjen e kontrolleve të këtyre kurbave. Gjithashtu ndihmojnë dhe në validimin e metodave që ne përdorim lidhur me selectivitetin, perseritshmerinë, produktivitetin, limitin e dedektimit pasi janë standarte të certifikuar.

Disa standarte nuk gjenden ne trajte te pluhuri si psh THC.

-Materialet referencë të porositura në formë mase (mg) janë destinuar kryesisht për verifikimin e kohës së mbajtjes (Retention Time Check). Këto materiale përdoren pak për ndërtimin e kurbave të kalibrimit,

pasi do të kërkonin përgatitjen paraprake të tretësirave stok dhe peshime me saktësi të lartë, duke rritur pasigurinë matëse. Për këtë arsye, përdorimi i tyre kufizohet në kontrolle identifikimi, verifikime të metodës kur është e nevojshme, si dhe në përgatitjen e solucioneve që përmbajnë standarde të brendshme (internal standards).

Gjithashtu, këto materiale përdoren për verifikimin e performancës së metodave si psh testet e ngjyrës), ku kërkohej të kontrollohet nëse një test punon apo jo.

-Disa standarde janë vënë në dy format nga ana jone ml ose mg në varesi të formës të cilat mund të sigurohen (shih listen) këto standarde nuk i përdorim për ndërtim kurbe kalibrimi, kështu që mund të përdoren të dy format nga ana jone pa na ndikuar në cilësinë e punës (nëse vjen në mg tretja mund të bëhet dhe nga ana jone).

Të jenë nga kompani të akredituar në ISO 17025 dhe ISO 17034;

Të shoqërohen standartet me certifikatë analize;

Skandencë jo më pak se dy vjet.

Shenim: Ambalazhimi, menyra e paketimit për të gjithë artikujt duhet të jetë në formatin 1mg ose 1 ml, sipas përshkrimit të kolonës “njësia”.

LOTI 2 “BLERJE STANDARTE EKSPLOZIVI”

Nr.	Emertimi
1	2
1	1,3,5-Trinitrobenzene (1,3,5-TNB), ampule 1 ml me përqendrim 1 mg/mL (Matrix 1000 µg/mL in AcCN: MeOH).
2	Nitrat Amoniumi (NH ₄ NO ₃), në trajtë pluhuri
3	Amonium Perklorate (NH ₄ ClO ₄), në trajtë pluhuri.
4	Natrium nitrite (NaNO ₂), në trajtë pluhuri.
5	Urea (CH ₄ N ₂ O), në trajtë pluhuri.
6	Natrium Klorate (NaClO ₃), në trajtë pluhuri.
7	Natrium Bromate (NaBrO ₃), në trajtë pluhuri.
8	Urea Nitrate (CH ₅ N ₃ O ₄), në trajtë pluhuri.
9	Pentaerythritol tetranitrate (PETN), ampule 1 ml me përqendrim 1 mg/mL (Matrix 1000 µg/mL in MeOH).
10	Nitroglycerin (NG), ampule 1 ml me përqendrim 1 mg/mL (Matrix 1000 µg/mL in ETOH: MeOH (97:3)).
11	2,4,6-Trinitrotoluene (TNT), ampule 1 ml me përqendrim 1 mg/mL (Matrix 1000 µg/mL in AcCN: MeOH).

12	Hexahydro-1,3,5-trinitro-1,3,5-triazine (RDX), ampule 1 ml me përqendrim 1mg/mL (Matrix 1000 µg/mL in AcCN: MeOH).
13	Octahydro-1,3,5,7-tetranitro-1,3,5,7-tetrazocine (HMX), ampule 1 ml me përqendrim 1mg/mL (Matrix 1000 µg/mL in AcCN: MeOH).

ARGUMENTIM I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE LOTI 2

Materialet referencë të porositura në përqendrime të certifikuara (në ml me përqendrim) janë parashikuar për kryerjen e analizave gjysëm sasiore, me qëllim përcaktimn e përafërt përqendrimeve të eksplozivëve më të rëndësishëm, si dhe kontrollin e RT me materiale të tretura dhe të certifikuara.

-Materialet referencë të porositura në formë pluhuri (gr) janë porositur si të tillë sepse janë më stabël në këtë formë dhe për ti lënë mundësi ekspertit ti tresë në solvent të ndryshëm në varësi të metodës së tij.

Te jene nga kompani te akredituar ne ISO 17025 dhe 17034;

-Te shoqerohen standartet me certifikate analize;

-Skandanca jo me pak se nje vit .

Njësia e prokurimit autorizon personin përgjegjës për prokurim për hedhjen e të dhënave në SPE.

NJËSIA E PROKURIMIT: